



**Vendim i Bordit Akademik
Nr. 1, datë 11 janar 2007**

Në zbatim të statutit të Institutit të Sociologjisë, Bordi Akademik në mbledhjen e tij të datës 11 janar 2007, vendosi:

I. Të miratojë kërkesën për anëtarësim në Institutin e Sociologjisë të:

1. Oriola Rrokaj (Tiranë);
2. Itena Hoxhallari (Tiranë);
3. Holta Koçi (Tiranë);
4. Anjeza Hoxhallari (Tiranë);
5. Juli Vullnetari (Anëtare korespondente - Universiteti Sussex, Brighton Angli)
6. Jan Nederveen Pieterse (Anëtarë Nderi, University of Illinois, USA)

Bordi akademik orienton nxitjen e anëtarësimeve të reja, sidomos nga individët shqiptarë me krijimtari të spikatur sociologjike, si dhe krijimin e bërthamave shkencore sociologjike (degëve), në universitetet të ndryshme publike e jo-publike të Shqipërisë. Për komunikimin me universitetet caktohen:

Universiteti i Tiranës, Fakulteti Shkencave Sociale - Nora Malaj;

Universiteti Zonja e Këshillit të Mirë, Lekë Sokoli;

Nju Jork University, Servet Pëllumbi;

Universiteti "Marin Barleti" - Nora Malaj, Zamira Çavo;

Faklteti Juridik Luarasi – Nora Malaj;

Universitetio Evropian i Tiranës – Enis Sulstarova;

Universiteti i Elbasanit – Lekë Sokoli;

Universiteti i Shkodrës – Tonin Çobani;

Universiteti i Durrësit – Alfred Uçi;

Universiteti i Korçës – Servet Pëllumbi;

Universiteti i Vlorës – Gëzim Tushi;

Universiteti i Gjirokastrës – Ilir Gëdeshi;

Të përgatiten Certifikatat e anëtarësisë së institutit (sipas modelit të miratuar) dhe të organizohet shpërndarja e tyre (deri më 31 janar, Lekë Sokoli, Denis Behluli).

II. Lidhur me propagandimin dhe njohjen e IS:

1. Të bëhet njoftimi për institutet analoge në botë, si dhe kërkesat për anëtarësimin në Shoqatën Evropiane të Sociologjisë, Shoqatën Botërore të Sociologjisë apo institucione e shoqata të tjera me intees për institutin (ngarkohet Drejtori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Fatos Tarifa).

2. Të krijohet rrjeti i komunikimit "Institutit i Sociologjisë" si dhe Web Site në internet në adresën www.instituti-sociologjise.org, në të cilën të pasqyrohet veprimtaria shkencore, botuese, publicistike, aplikative (projektet) etj. të institutit (ngarkohen Lekë Sokoli dhe Denis Behluli).

3. Të krijohet një forum debati për çështje të mendimit politik shqiptar (etj.), në një gazetë të përditshme (Servet Pëllumbi, Alfred Uçi, Nora Malaj, Enis Sulstarova, Gëzim Tushi, Tonin Çobani, Jashar Demiri, Skënder Demaliaj, Sotiraq Hroni, Fatos Tarifa, Lekë Sokoli, Blendi Ceka, Zamira Çavo e anëtarët e tjerë të institutit).



Instituti i Sociologjisë - IS
Albanian Institute of Sociology - AIS

Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 3/3, Tiranë

Tel & fax: ++ 355 (4) 268 819;

Mobile: ++ 355 (0) 692032731;

E-mail: lsokoli@instituti-sociologjise.org

Web site: www.instituti-sociologjise.org

Të synohet, gjithashtu, që të krijohet një forum debati për çështje të mendimit politik etj., në një nga TV kombëtare (N. Malaj)

III. Botimi i revistës “Politika & Shoqëria”, si organ i IS & ISPS

Sponsorizimi i botimit (Servet Pëllumbi, Nora Malaj).

Materialet (Lekë Sokoli, Sejdin Cekani);

Diskutimi mbi riformatimin, bordin botues etj. (S. Pëllumbi, F. Tarifa, L. Sokoli, Sejdin Cekani);

IV. Të zhvillohet Konferenca e Parë Kombëtare e Studimeve Sociologjike (qershor 2007).

Grupi i punës për përgatitjen e saj: Servet Pëllumbi, Enis Sulstarova, Lekë Sokoli.

V. Çdo anëtar i Institutit të Sociologjisë mund të jetë hartues, aplikant, drejtues, kordinator dhe zbatues projektesh të financuara nga donatorë dhe sponsorizues të ndryshëm, vendas apo të huaj. Objektivat e projekteve duhet të përputhen me objektivat e Institutit të Sociologjisë, të shprehura në statutin e tij (shih neni 15 i statudit). Kriteri bazë i vlerësimit të projekteve do të jetë serioziteti, rritja e prestigjit publik të institutit si dhe angazhimi i anëtarëve të tjerë të IS, sidomos anëtarët më të rinj të tij. Për monitorimin e projekteve ngarkohet drejtori ekzekutiv dhe financieri.

VI. Të hartohet rregullorja e vlerësimit të kontributeve të anëtarëve të IS lidhur me kerkimin shkencor sociologjik (Lekë Sokoli, janar 2007).

VII. Në zbatim të nenit 15 të statudit (sipas të cilit çdo anëtar i IS duhet të paguaj kuotizacionin e anëtarësisë), vendoset që kuota vjetore, për anëtarët aktivë që janë në marrëdhënie pune, të jetë 1000 lekë. Për kohën që ndonjëri nga anëtarët e Institutit të Sociologjisë nuk është në marrëdhënie pune dhe nuk ka burim tjetër të ardhurash kuota vjetore të jetë 500 lekë në vit. Kuotizacioni i anëtarësisë të zbatohet nga nga viti 2007.

Kryetari i Bordit Aademik

Servet Pëllumbi
(dv)